



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE PJESËTARE E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për pranimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë, të paraqitura nga "Partia Demokracia Sociale", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga "Partia Demokracia Sociale", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Demokracia Sociale, me vendimin e KQZ-së nr. 197, datë 23.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe "Partia Demokracia Sociale".

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë,



**Nr. 629 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Demokracia Sociale", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Shkodër, Tiranë. KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkive:

- Fier me vendimin nr. 524 datë 18.05.2019.
- Korçë me vendimin nr. 526 datë 18.05.2019.
- Shkodër me vendimin nr. 529 datë 18.05.2019.

Brenda afatit Partia Demokracia Sociale, ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimeve të KQZ-së për Bashkinë Korçë, Fier, Shkodër.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive: Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë; pasi bashkitë Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë të propozuar nga Partia Demokracia Sociale;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit;

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë, të Partisë "Partia Demokracia Sociale" dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në Këshillat Bashkiak Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezultoi se:



### **Lista shumemërore e Bashkisë Shkodër:**

1. Kandidati me numër **rendor 6, znj. Safete Bajram Beshi** në bazë të Vendimit nr.47 datë 04.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gyqësor Shkodër është deklaruar fajtorë për veprën penale të vjedhjes së Energjisë Elektrike, parashikuar nga nene 137/2 i Kodit Penal dhe është dënuar me 50.000 Lekë gjobë.  
Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

### **Lista shumemërore e Bashkisë Elbasan:**

1. Kandidati me numër **rendor 3, z. Ardian Stefan Berdufi** në bazë të Vendimit nr. \_\_ viti 1993 të Gjykatës së Rrethit Gyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga nene 237/1, 244, 35 i Kodit Penal dhe është dënuar 1 muaj dhe 11 ditë burgim.  
Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Elbasan, Vlorë, Kamëz, Korçë, Shkodër, Tiranë të Partisë "Demokracia Sociale", pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

